27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. prot. Tiranë, më 15.11.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion të datës 1.11.2022

ZNJ. A J
ZNJ. M J

Të dhëna kontakti: e-mail:
Cel.:

Të nderuara,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, dërguar me e-mail më datë 1.11.2022 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me postë zyrtare në datën 2.11.2022, protokolluar me tonën nr. prot., ju informojmë se:

Raporti i kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit z. S D gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, është një dokument që administrohet nga KPK vetëm për qëllim të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Sipas asaj që informoni ju përmes e-mail-*it* dhe shkresës së depozituar pranë KPK-së, bazuar në nenin DH, pika 2, të Aneksit Kushtetues dhe të kreut V të ligjit nr. 84/2016, dokumenti që kërkohet nga ju, si dhe informacioni që përmban raporti për figurën, ka të dhëna sensitive dhe informacion të klasifikuar "sekret shtetëror", të cilat përdoren vetëm për procesin e rivlerësimit kalimtar dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Për rrjedhojë, dokumenti i kërkuar nga ju, nuk i vihet në dispozicion palëve të treta jashtë këtij procesi dhe nuk mund të përdoret si provë në një proces penal, sa kohë që vetë ligjvënësi e ka parashikuar shprehimisht një ndalim të tillë në nivel kushtetues.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se e drejta për informim dhe marrje dokumentesh, sipas objektit të kërkesës suaj, është një e drejtë e kufizuar, e parashikuar shprehimisht në pikën 2/"dh", të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informdimit".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Edmond Çerçani